PËRMBAJTJA

I. PERSHKRIMI I PLANIT STRATEGJIK 3
I.1. Qëllimi i Planit Strategjik 3
I.2. Misioni i Auditimit të Brendshëm 3
I.3. Organizimi i NJAB 4
I.4. Kuadri Ligjor 4
I.5. Objektivat Strategjik 4
I.6. Identifikimi i subjekteve 5
I.7. Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare 5
I.8. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve 6
I.9. Kufizimet e Auditimit 8
I.10. Prioritetet dhe fokusimi i veprimtarisë audituese për vitet (1+2) 9
II. MISIONI DHE OBJEKTI I PUNËS 9
III. AKTIVITETI KRYESOR 10
III.1. Objektivat e Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023 11
III.2. Planifikimi i auditimeve për vitin 2023 11
IV. FUSHAT PRIORITARE TE AUDITIMIT 13
IV.1. Auditimi i pikave të Inspektimit Kufitar (PIK) 13
IV.2. Auditimi i Procedurave të Inspektimit në Operatorët e Biznesit Ushqimor 13
IV.2.1. Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Jo Shtrazore (OSH dhe OJSH) dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor. 13
IV.2.2. Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore 14
V. AUDITIME FINANCIARE PËR TË GJITHA STRUKTURAT E VARTËSISË SË AKU-së, TË PLANIFIKUARA. 14
V.1. Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në kryerjen e shpenzimeve dhe të ardhurave 14
V.2. Auditim në drejtim të zbatimit të procedurave për prokurimet publike 15
V.3. Auditim mbi administrimin e vlerave materiale, inventarëve dhe sistemimin e tyre... 15
V.4. Auditim mbi mbajtjen e kontabilltetit dhe mbylljen e llogarive vjetore 15
VI. AUDITIM I ZONAVE DHE SISTEMEVE ME RISK TË LARTË 16
VII. PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË AUDITIMIT 16
VIII. BILANCI I BURIMEVE DHE NEVOJAVE PËR AUDITIM 17
IX. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË 17

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME
SEKTORI I AUDITIMITT TË BRENDSHËM

Nr _____Prot. **Tiranë, më ___.___.2022**

M I R A T O H E T

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

JETA DEDA

PLANI STRATEGJIK DHE VJETOR I VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR PERIUDHËN 2023-2025

Në zbatim të kërkesave të nenit 6, pika "a" dhe nenit 14, pika "c" të Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*", dhe të Kapitullit III të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 100, datë 25.10.2016 "*Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", auditimi i ushtruar për vitin 2022 ka synuar të përfshijë ato subjekte të saj të auditimit, të cilat lidhen me misionin dhe qëllimin për të cilën ajo funksionon. Bazuar në kapitullin III të manualit, veprimtaria audituese për vitin 2022 është orientuar në: Auditimin e sistemeve dhe vlerësimin në thellësi të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të vendosur nga niveli i menaxhimit, me qëllim përcaktimin nëse ato funksionojnë me kosto efektive, në mënyrë eficente dhe për arritjen e objektivave. Duke u mbështetur në programin e realizuar si nëntë mujor për vitin 2022 dhe në zbatim të ligjit të cituar më sipër, si dhe rekomandimeve nga KLSh, Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit ka përgatitur Programin Vjetor për vitin 2023 dhe planin strategjik (1 +2) deri në vitin 2025.

I. PERSHKRIMI I PLANIT STRATEGJIK

I.1. Qëllimi i Planit Strategjik

Qëllimi i Planit Strategjik të Konsoliduar "Mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik për vitet 2023-2025 dhe Plani Vjetor 2023" është:

"*Të përcaktojë drejtimet në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë periudhës për të cilën po hartohet ky plan, kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave duke u bazuar në analizën e riskut për fushat/sistemet të cilat mbulon ky funksion"*

Angazhimet e auditimit të brendshëm në Planin Strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave tre vjeçare për auditime. Frekuenca e auditimit, përcaktohet nga drejtimi i auditimit të brendshëm, duke u bazuar në shkallën e riskut që shoqëron këtë funksion gjatë implementimit të tij si dhe në raste të veçanta sipas gjykimit të drejtimit.

Të përcaktojë punën që do të kryejë NJAB e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për periudhën 3-vjecare 2023-2025.

Në këtë plan strategjik do të programohen veprimtaritë kryesore të planifikuara, për të siguruar që sistemet/fushat e identifikuara me risk, mbulohen me auditim gjatë kësaj periudhe.

I.2. Misioni i Auditimit të Brendshëm

Të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik.

Roli i auditimit të brendshëm është t'i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, duke:

Përgatitur planet strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e auditimeve në përputhje me planin e miratuar;

Vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve dhe të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:

a) identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
b) përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
c) ruajtjen e aseteve;
d) besueshmërinë dhe gjithë përfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
e) kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe eficencë;
f) përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve në fushën e sigurisë ushqimore.
g) Dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike dhe ndjekur zbatimin e tyre.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm siguron titullarin e organizatës (subjektit të audituar, si dhe Menaxhimin e Lartë se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet dhe eficencë dhe sipas planit dhe qëllimit të miratuar me ligjin e buxhetit, si dhe proceset operacionale të organizatës, janë në përputhje me aktet rregullative dhe efikase, referuar misionit të organizatës.

I.3. Organizimi i NJAB

Sektori i Auditimit të Brendshëm është organizuar si Sektor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU. Ky sektor ka në përbërjen e tij tre punonjës sipas strukturës së miratuar, me sistemin 2+1. Njësia e auditimit të brendshëm ka varësi direkte nga titullari i institucionit (Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së). Organizimi, funksionimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik". ***Stafi i njësisë së auditimit të brendshëm është jo plotësisht i certifikuar, për faktin se një anëtar i tij është i pa certifikuar, meqënëse ka filluar marrëdhëniet e punës në fund të vitit 2020. Sqarohet se janë kryer procedurat e regjistrimit për certifikimin, referuar kjo njoftimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë dhe certifikimi konsiderohet në proces.***
Stafi i njësisë së auditimit, ndjek trajnimet e vijueshme që janë organizuar nga NJQH, për temat e të ndryshme , duke përfshirë edhe temat e kërkuara në programin vjetor dhe strategjik.

I.4. Kuadri Ligjor

Funksionimi i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik bazohet në Ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin Nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit Financave, si dhe akte të tjera nënligjore, të cilat janë pjesë e paketës ligjore për rregullimin e kësaj veprimtarie.

I.5. Objektivat Strategjik

Objektivat kanë për qëllim që të përcaktojnë drejtimet në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik gjatë periudhës për të cilën po hartohet ky plan, kohën dhe burimet e nevojshme për realizimin e objektivave duke u bazuar në analizën e riskut për fushat/sistemet të cilat mbulon ky funksion.
Në mënyrë më specifike objektivat në kuadrin e gjithë sistemit e detajuar shërbejnë për të:

- Dhënë siguri objektive tek titullarët, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve financiare dhe raporteve të performancës, të përgatitura nga strukturat e menaxhimit;
- Ndihmuar menaxhimin e sektorit publik në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet e njësisë;
- Ndihmuar subjektet për të qenë të përgjegjshëm ndaj publikut, duke:
    - Vlerësuar zbatimin e ligjit, rregulloreve dhe kontrolleve të vendosura, si dhe duke siguruar dobinë, frytshmërinë dhe kursimin e veprimeve;
    - Ndihmuar punonjësit në përmirësimin e performancës së përgjithshme të punës dhe në zbatimin e kontrolleve të vendosura;
    - Minimizuar mundësitë për mashtrim, shpërdorim dhe abuzim.

I.6. Identifikimi i subjekteve

Sektori auditimit të brendshëm në Autoritetin Kombëtar të ushqimit mbulon me auditim Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, në të cilën përfshihen katër Drejtori, si dhe 12 Drejtori Rajonale konkretisht;

- Drejtoria e Përgjithshme e AKU-së (katër, Drejtori si dhe Sektori i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar);
    - Drejtoria e Menaxhimit të Riskut dhe Kordinimit të Kontrollit Zyrtar.
    - Drejtoria Vlerësimit të Riskut;
    - Drejtoria e Komunikimit të Riskut dhe monitorimit.
    - Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme;
- Drejtoria Rajonale AKU Tiranë;
- Drejtoria Rajonale AKU Durrës;
- Drejtoria Rajonale AKU Korçë;
- Drejtoria Rajonale AKU Shkodër;
- Drejtoria Rajonale AKU Vlorë;
- Drejtoria Rajonale AKU Gjirokastër;
- Drejtoria Rajonale AKU Fier;
- Drejtoria Rajonale AKU Elbasan;
- Drejtoria Rajonale AKU Kukës;
- Drejtoria Rajonale AKU Lezhë;
- Drejtoria Rajonale AKU Dibër;
- Drejtoria Rajonale AKU Berat.

Totali i subjekteve të cilët auditohen nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit janë 13.

I.7. Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare

Për realizimin e veprimtarisë audituese, një ndër elementët kryesor është identifikimi i fushave me prioritet ku dhe do të fokusohet veprimtaria e auditit të brendshëm. Me qëllim realizimin e auditimit me bazë risku mbetet i nevojshëm përcaktimi dhe identifikimi i fushave dhe sistemeve.
Siç përmendet dhe në manualin e auditimit të brendshëm, disa nga komponentët më të rëndësishëm për hartimin e planit të auditimit janë;

- Njohja e mirë e organizatës e cila do të auditohet;
- Risqet që i kanosen organizatës të cilët ndikojnë negativisht në arritjen e objektivave të njësisë dhe;
- Mjedisi ku organizata vepron.

Numri i subjekteve	**PLANIFIKUAR PËR AUDITIM VITE (1+2)**		
	Viti 2023	**Viti 2024**	**Viti 2025**
13	**9**	**8**	**9**

I.8. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve

Njësia e auditimit të brendshëm në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit ka identifikuar dhe vlerësuar risqet bazuar në ato faktorë të cilët kanë mundësi më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur e cila mund të pasojë me një ndikim negativ për realizmin e objektivave të organizatës. Në këtë informacion përcaktohen fushat të konsideruara me risk që do të mbulohen për auditim për vitet 2023-2025.

Në vlerësimin e riskut janë marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Risqet e brendshme dhe të jashtme ndaj të cilat ekspozohet subjektit që auditohet;
- Organizimi dhe kompleksiteti i subjekteve (*aktivitetet komplekse janë më të vështira për t'u bërë mirë dhe mund të ndikojë në mos realizimin e objektivave të organizatës)*;
- Kuadri ligjor dhe rregullator, i cili ka pësuar ndryshime dhe pritet të ndryshojë më tej.
- Mjedisi i kontrollit (*verifikimi nëse organizata i ka të qarta objektivat, rolet dhe përgjegjësitë organizative, standardet etike të sjelljes etj.*);
- Ndryshimeve që mund të pësoj organizata apo sistemi, ndryshime në drejtim të menaxhimit, si dhe strukturës dhe organikës etj.
- Potenciali për mashtrim pasi disa aktivitete apo sisteme janë më të prirur për mashtrim dhe korrupsion, veçanërisht në fushën e inspektimeve.
- Koha që nga auditimi i fundit (*subjektet që nuk janë kontrolluar për disa vite për shkak të vlerësimit me risk të ulët, mund të bëhen me risk të lartë).*

Për të mbuluar me auditim të gjithë sistemeve të njësisë publike vlerësohen fushat/sistemet e përzgjedhura për auditim sipas paraqitjes në diagramin e mëposhtëm ;

Strategjia e auditimit bazohet në tre klasifikime sa i përket frekuencës së auditimit, konkretisht;

Fusha me risk të lartë	**e këshillueshme një herë në vit**
Fusha me risk të mesëm	**e këshillueshme një herë në dy- tre vite**
Fusha me risk të ulët	**e këshillueshme jo më shumë se pesë vite**

Bazuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm për vlerësimin e ndikimit të riskut u përdorën kriteret e mëposhtëm;

- Strategjik
- Operacional
- Reputacioni
- Financiar
- Përputhshmëria.

NjAB ka përllogaritur një shkallë vlerësimi të çdo nënkategorie nga 1-3 *(i ulët 1; i mesëm 2; i lartë 3)* për secilin fushë/sistem të njësisë publike. Vlerësimi i faktorëve të riskut bëhet për të

krijuar një panoramë të qartë të risqeve që kërcënojnë objektivat e njësisë publike. Përdorimi i faktorëve të riskut për të përzgjedhur auditimet që do kryhen në planin vjetor, kanë për qëllim minimizimin e riskut humbjeve që mund të pësojë njësia publike dhe përdorimin me efektivitet dhe eficencë të burimeve të auditimit.

Gjatë përgatitjes së këtij plani është mbajtur në konsideratë edhe fakti që auditimet të jenë me sa më pak kosto dhe në këtë kontekst, përveç riskut sipas fushave dhe sistemeve, është konsideruar edhe numri i subjekteve për auditim, shpërndarja e tyre gjeografike, me qëllim që në një auditim të përfshihen të gjitha fushat, fillimisht ato me risk të lartë dhe më pas ato me të mesëm dhe të ulët, duke mos tejkaluar afate mbi 2 vjet, për çdo njësi vartësie.

Gjithashtu sqarojmë se në lidhje me fushat e IT, nuk do të parashikohet auditim, për faktin se nga KLSH është kryer një auditim për këtë fushë gjatë vitit 2022. Edhe për fushën e menaxhimit të fondeve IPA janë kryer auditime nga struktura përkatëse e auditimit për fondet e BE, pranë Ministrisë Financave.

Pas vlerësimit të faktorëve të riskut, dhe për të përcaktuar prioritetet për njësitë të cilat do të auditohen NjAB shqyrtoi të gjithë faktorët e rëndësishëm të njësisë dhe ndikimin e secilit prej tyre sipas formulës për llogaritjen e indeksit të riskut të parashikuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm;

Indeksi i riskut = (S x 20) + (O x 15) + (R x 25) + (F x 30) + (C x 10)

Sipas vlerësimit që rrjedh nga vlerat e llogaritura të indeksit të riskut në formulën e mësipërme, NjAB përcaktoi se cilat njësi janë më prioritare për t'u audituar sipas intervalit të mëposhtëm.

Intervali i treguesit të riskut	Niveli i riskut
< 150	I ulët
150 – 250	I mesëm
251 – 300	I lartë

Më poshtë japim rezultatin e vlerësimit dhe përzgjedhjes së proceseve për planin e auditimit.

NR.	Proceset e audituesh me	Vlerësimi i Riskut	Risku
1	Plani dhe realizimi i inspektimeve me bazë risku në terren si dhe plani i marrjes së mostrave dhe realizimi nga inspektorët e terrenit dhe PIK.	300	I Lartë
2	Dokumentacioni shoqërues për produktet e importit që paraqiten në Pikat e Kalimit Kufitar dhe Doganat e Brendshme. Aplikimi i tarifave të shërbimit dhe rakordimi i tyre.	300	I Lartë
3	Debitorët dhe detyrimet e prapambetura	285	I Lartë
4	Ndjekja e realizimit të detyrave të lëna gjatë procedurës së inspektimit.	265	I Lartë
5	Procedurat dhe afatet e notifikimit të etiketave.	245	I Mesëm
6	Procedurat e njoftimeve për rastet ALERT në fushën e sigurisë ushqimore.	225	I Mesëm
7	Administrimi i aktiveve iventar/magazinë	215	I Mesëm
8	Zbatimit të procedurave të prokurimeve publike për blerje mallrash dhe shërbimesh.	200	I Mesëm
9	Procedura e komisionit të ankimimeve (administrimi ankesave, afatet, informacioni për DRAKU-të Rajonale).	200	I Mesëm
10	Respektimi i strukturës dhe organikës, pagat, shtesat mbi pagë si dhe verifikimi pagesës së vjetërsisë dhe diplomës.	200	I Mesëm
11	Pagesat e kryera për Udhëtime e Dieta (brenda vendit)	200	I Mesëm
12	Administrimi i karburantit.	180	I Mesëm
13	Administrimi / përdorimi i dokumentacionit zyrtar në PIK	170	I Mesëm

I.9. Kufizimet e Auditimit

Ekzistojnë faktorë që ndikojnë në realizimin dhe kufizimin e funksionit të auditimit të brendshëm duke qenë se kjo veprimtari është në proces të vazhdueshëm ndryshimi. Në kufizimet e auditimit, duke bërë analizën e prirjes për periudhën tre vjeçare, mund të përmendim:

- Ndryshimet e shpeshta strukturore dhe në staf, në Drejtorinë e Përgjithshme dhe njësitë e vartësisë;
- Shkalla e ulët e ndërgjegjësimit të drejtuesve të subjekteve për rëndësinë dhe rolin e AB si konsulencë e mbështetje për vlerësimin dhe përmirësimin e sistemeve të Kontrollit të brendshëm e qeverisjes;
- Mos marrja në analizë apo konsideratë e rekomandimeve të dhëna nëpërmjet raporteve Finale të Angazhimit nga struktura audituese dhe neglizhenca e titullarëve të subjekteve të audituara për zbatimin e përfundimeve të auditimit të dala nga titullarët për konfirmimin e këtyre raporteve;
- Përdorimi i auditimit të brendshëm jo në pajtueshmëri me ligjin;
- Niveli i pamjaftueshëm i njohurive profesionale i audituesve të brendshëm, që nënkupton vështirësi në gjetjen dhe angazhimin e një stafi të trajnuar me aftësi dhe mjeshtëri që t'i përgjigjen kërkesave të një sistemi modern të KBFP;
- Bashkëpunimin e pa mjaftueshëm me institucionet e tjera, në funksion të realizimit të objektivave të Institucionit (Tatime, Dogana, Inspektoratit Qendror, QKB, Zyra Përmbarimore, Ministrinë e Drejtësisë, Ministri linje).

I.10. Prioritetet dhe fokusimi i veprimtarisë audituese për vitet (1+2)

- Evidentimin dhe vlerësimin e ecurisë së përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar;
- Për të parë nivelin e riskut të identifikuar për organizatën;
- Procesin e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve;
- Identifikimin dhe shqetësimet e menaxhimit dhe risqe të tjera për të cilat audituesit mund të mos kenë dijeni dhe për pasojë mund të mos jenë vlerësuar me risk;
- Është mbajtur në konsideratë fakti se auditimet janë fokusuar edhe tek subjektet, të cilat kanë mbi 2 vjet pa u audituar dhe faktit që në këto subjekte ka fusha dhe sisteme të vlerësuara me risk të lartë, të mesëm ose të ulët, këto subjekte kur të auditohen do të auditohen për të gjitha fushat dhe sistemet, pra pavarësisht riskut, sepse edhe sistemet dhe fushat me risk të mesëm, dhe të ulët, tashmë janë bërë të lartë.

PËRSHKRIMI I PLANIT VJETOR

II. MISIONI DHE OBJEKTI I PUNËS

Misioni i Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit është të japë siguri objektive dhe të pavarur si dhe shërbime konsulence, i krijuar që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë funksionimin e njësisë së audituar. Ai ndihmon njësinë që të përmbushë objektivat e veta duke ofruar një trajtim sistematik dhe të disiplinuar, për vlerësimin dhe përmirësimin me efektivitet të proceseve të menaxhimit të riskut.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së, duke qenë se ushtron një veprimtari të pavarur, në çdo kohë informon nëpërmjet raporteve dhe Memorandumeve dhe asiston Drejtorin e Përgjithshëm të AKU-së në lidhje me funksionimin e veprimtarisë dhe të aktiviteteve në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në Drejtoritë Rajonale të AKU-së, në drejtimet e mëposhtme nëse:

- Realizohen programet, planet dhe objektivat e punës, në zbatim edhe të akteve rregullative në fuqi;
- Risqet identifikohen dhe menaxhohen në mënyrën e duhur;
- Informacioni kryesor financiar, menaxherial dhe operacional është i saktë, i besueshëm dhe në kohë;
- Aktivet ruhen dhe administrohen në mënyrë korrekte;
- Burimet financiare, përdoren me eficencë dhe mbrohen në mënyrë të përshtatshme;
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm;
- Çështjet e rëndësishme legjislative dhe rregullatore janë integruar në procesin e kontrollit të brendshëm;
- Veprimet e punonjësve janë në përputhje me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme;

- Vlerësimin e performancës së veprimtarisë së institucionit si në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në Institucionet e vartësisë.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Sektori i Auditimit të Brendshëm mbështetet në zbatimin e legjislacionit të fushës, rregullat teknike të formalizuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, në Kodin e Etikës dhe Kartën e Audituesit të Brendshëm, si dhe në standardet e Auditimit të Brendshëm.

III. AKTIVITETI KRYESOR

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të AKU-së zhvillon veprimtarinë audituese në mënyrë të planifikuar dhe në mënyrë të detajuar dhe të specifikuar për çdo auditim. Kjo e planifikuar mbi bazën e vlerësimit të riskut për çdo njësi brenda Drejtorisë së Përgjithshme të AKU- së, si dhe Drejtorive Rajonale të vartësisë. Veprimtaria audituese është e strukturuar në bazë të ligjit Nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"*, Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kartën dhe Kodin e Etikës së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, të rishikuar dhe miratuar me shkresën nr. 1633, datë 29.04.2021. Ajo zhvillohet bazuar në programin e punës i hartuar në mënyrë të detajuar për çdo njësi që auditohet për;

- vlerësimin e kontrolleve apo të masave që janë vendosur nga menaxhimi, që kanë si synim adresimin e risqeve;
- identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe dhënien e kontributeve në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut;
- inkurajimin e kontrolleve efektive dhe eficente dhe nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm në këtë drejtim;
- vlerësimin dhe theksimin e proceseve që garantojnë besueshmërinë dhe integritetin e informacionit financiar dhe operacional.

Qëllimi kryesor i auditimit është dhënia e një sigurie të arsyeshme për drejtuesit që këto komponentë janë zhvilluar në përputhje dhe në zbatim të ligjeve në fuqi, nëse fondet publike janë përdorur me efektivitet dhe me eficencë, asetet janë ruajtur dhe nuk janë shpërdoruar, dëmtuar apo vjedhur, veprimtaria inspektuese është efikase në funksion të sigurisë ushqimore, si dhe për matjen e performancës së punës në njësitë e audituara, nëse ka qenë e mirë dhe në funksion të realizimit të objektivave të institucionit. Të gjitha rekomandimet që auditi jep në përfundim të misionit të tij audites të cilat bazohen në gjetjet e auditimit, i shërbejnë drejtimit të organizatës apo menaxhimit, të përmirësojë sistemet, përdorimin e fondeve dhe shtimin e vlerës së organizatës dhe minimizimin e risqeve të mundshme që dëmtojnë organizatën në të gjithë aspektet e saj. Sektori i Auditimit të Brendshëm i raporton drejtpërdrejtë titullarit të institucionit për të gjithë veprimtarinë e realizuar prej tij. Audituesit e Brendshëm janë të pavarur në dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve të tij, të cilat janë të bazuara në rezultatet e auditimit, të paanshme, objektive, të strukturuara, të specifikuara dhe të arritshme nga njësia që auditohet.

III.1. Objektivat e Sektorit të Auditit të Brendshëm për vitin 2023

- Organizimin dhe kryerjen e auditimeve konform Planit Vjetor të miratuar, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të auditimit;
- Kryerjen e auditimeve me objektivitet, paanshmëri, profesionalizëm dhe me efektshmëri të lartë;
- Mbulimin e të gjitha fushave të veprimtarisë si në aspektet financiare, por edhe të proceseve;
- Raportimin dhe ndjekjen e veprimtarive pasuese për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve nga ana e njësive të audituara, si dhe përmirësimin e cilësisë së rekomandimeve;
- Mbështetjen e njësive dhe të menaxhimit në dhënien e këshillave për arritjen e objektivave;
- Rritjen e cilësisë së raportimit, duke synuar raportim konciz të strukturuar dhe eficent;
- Rritja e nivelit tekniko - profesional të punonjësve të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në seminare dhe praktika trajnuese;(trajnimi i vijueshëm);
- Rritjen e nivelit të bashkëpunimit, me të gjitha strukturat e organizatës.

III.2. Planifikimi i auditimeve për vitin 2023

Për vitin 2023, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka planifikuar të realizojë 8(tetë) auditime, duke mbuluar me auditim subjekte të varësisë në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit sipas fushave dhe sistemeve të caktuara, duke u mbështetur në nivelin e riskut që është evidentuar gjatë auditimeve të kryera në vitin 2022 si dhe gjetjeve dhe rezultateve të auditimeve të kryera, si dhe frekuencës së auditimeve, pasi disa organizata kanë dy vjet pa u audituar dhe në këtë kontekst, ato përbëjnë prioritet. ***Gjatë vitit 2023 auditimet do të konsistojnë dhe përqëndrohen në ato fusha apo sisteme që paraqesin risk të lartë dhe që kërkojnë më shumë kohë të shpenzohet për të kryer auditimin, kjo veçanërisht për inspektimet e terreni, realizimit të planit të tyre, realizimit të planit të marrjes së mostrave, vlerësimin e dokumentacionit shoqërues për produktet e importit administrimit të të ardhurave.***

Në mënyrë të përmbledhur subjektet për auditim dhe fushat kryesore të auditimeve:

Auditime të përputhshmërie

1- **Zbatimi i Rekomandimeve**. Auditimi për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë viteve 2021 dhe 2022, për të gjitha subjektet e audituara

Auditime Financiare

2- **Drejtoria e Përgjithshme e AKU (**Shpenzimet, për punët, mallrat dhe shërbimet (prokurimet), administrimi magazines, administrimi i karburantit, shpenzimet për

udhëtime dhe dieta, shpenzimet për pagat, sigurime, tatime, shtesa mbi pagë si dhe verifikimi pagesës për vjetërsi në punë.

Auditime të kombinuara *(financiare dhe përputhshmërie).*

3- **Drejtoria Rajonale e AKU/Vlorë**, Detyrimet e prapambetura, plani dhe realizimi i inspektimeve si dhe plani dhe realizimi i marrjes së mostrave, në terren dhe PIK, të ardhurat PIK/Laborator/Certifikata dhe shpenzimet, shpenzimet për prokurimet publike, administrimi i aktiveve, debitorët dhe detyrimet e prapambetura, procedurat e notifikimit të etiketave, vlerësimi i dokumentacionit shoqërues për produktet e importit, OSH dhe MBIB) Ndjekja e detyrave të lëna nga inspektimet.

4- **Drejtoria Rajonale e AKU/Berat,** (Detyrimet e prapambetura, plani dhe realizimi i inspektimeve si dhe plani dhe realizimi i marrjes së mostrave, të ardhurat dhe shpenzimet, shpenzimet për prokurimet publike, administrimi i aktiveve, debitorët, procedurat e notifikimit të etiketave, vlerësimi i dokumentacionit që shoqëron produktet e importit, (OSH dhe MBIB) Ndjekja e detyrave të lëna nga inspektimet.)

5- **Drejtoria Rajonale e AKU/Korçë**, (Detyrimet e prapambetura, plani dhe realizimi i inspektimeve si dhe plani dhe realizimi i marrjes së mostrave, në terren dhe PIK të ardhurat PIK/Laborator/Certifikata, dhe shpenzimet, shpenzimet për prokurimet publike, administrimi i aktiveve, debitorët si dhe procedurat e notifikimit të etiketave. Vlerësimi i dokumentacionit që shoqëron produktet e importit, (OSH dhe MBIB). Ndjekja e detyrave të lëna nga inspektimet.)

6- **Drejtoria Rajonale e AKU/Gjirokastër** (Detyrimet e prapambetura, plani dhe realizimi i inspektimeve si dhe plani dhe realizimi i marrjes së mostrave, në terren dhe PIK, Vlerësimi i dokumentacionit që shoqëron produktet e importit (OSH dhe MBIB), të ardhurat dhe shpenzimet, shpenzimet për prokurimet publike, administrimi i aktiveve, debitorët, si dhe procedurat e notifikimit të etiketave. Ndjekja e detyrave të lëna nga inspektimet.

7- **Drejtoria Rajonale e AKU/Tiranë**, (Detyrimet e prapambetura, plani dhe realizimi i inspektimeve si dhe plani dhe realizimi i marrjes së mostrave, në terren dhe PIK, Vlerësimi i dokumentacionit që shoqëron produktet gjatë importit,(OSH dhe MBIB) të ardhurat dhe shpenzimet, shpenzimet për prokurimet publike, administrimi i aktiveve, debitorët, si dhe procedurat e notifikimit të etiketave. Ndjekja e detyrave të lëna nga inspektimet.

8- **Drejtoria Rajonale e AKU/Elbasan**, (Detyrimet e prapambetura, plani dhe realizimi i inspektimeve si dhe plani dhe realizimi i marrjes së mostrave, të ardhurat dhe shpenzimet, shpenzimet për prokurimet publike, administrimi i aktiveve, debitorët, si dhe procedurat e notifikimit të etiketave. Ndjekja e detyrave të lëna nga inspektimet.

9- **Drejtoria Rajonale e AKU/Fier**, (Detyrimet e prapambetura, plani dhe realizimi i inspektimeve si dhe plani dhe realizimi i marrjes së mostrave, vlerësimi i dokumentacionit që shoqëron produktet e importit, (*OSH dhe MBI*B) të ardhurat dhe

shpenzimet, shpenzimet për prokurimet publike, administrimi i aktiveve, debitorët, si dhe procedurat e notifikimit të etiketave.

Në të gjitha rastet, do të parashikohet në programet e veçanta për çdo njësi që do të auditohet edhe rubrika e veçantë "*Të ndryshme gjatë auditimit*".

IV. FUSHAT PRIORITARE TE AUDITIMIT

Mbështetur në objektivat dhe prioritetet e punës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Sektori i Auditimit të Brendshëm pranë këtij institucioni ka përcaktuar fushat prioritare të auditimit për vitin 2023, të cilat do të materializohen në programet e auditimit si më poshtë,

IV.1. Auditimi i pikave të Inspektimit Kufitar (PIK).

Sektorët e inspektimit që veprojnë në Pikat e Kalimit Kufitar do të auditohen në drejtim të administrimit të të ardhurave, aplikimit të tarifave si dhe mirë administrimit të dokumentacionit, në referim të:

- Vlerësimi i dokumentacionit shoqërues për importin e produkteve që hyjnë në vendin tonë, nëpërmjet PIK**.(për produktet OSH dhe MBIMB);**
- Zbatimit të Udhëzimit Nr. 8, datë 08.05.2007 mbi "Tarifat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të MBUMK-së";
- Zbatimit të VKM Nr. 750, datë 14.07.2010 "Për miratimin e rregullave të Inspektimit karantinor fitosantar" aneksi X;
- Administrimit, përdorimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit të praktikave të inspektimit si për importet dhe eksportet;
- Plotësimit dhe administrimit të regjistrave manual të inspektimit si për importet ashtu edhe për eksportet;
- Rakordimet me Zyrën e Financës për të ardhurat (sipas urdhrave dhe udhëzimeve përkatëse);
- Funksionimi i kontrollit të brendshëm, vlerësimi i tij.

IV.2. Auditimi i Procedurave të Inspektimit në Operatorët e Biznesit Ushqimor

IV.2.1. Sektori i Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me Origjinë Shtazore dhe Jo Shtazore (OSH dhe OJSH) dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor.

Ky sektor do të auditohet në drejtim të respektimit dhe zbatimit të legjislacionit të sigurisë ushqimore, për detyrat e lëna subjekteve, objekt inspektimi dhe verifikimit të zbatimit të tyre;

- Ligji Nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar;
- Ligji Nr.10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. l0465, datë 29.9.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë";
- Akti Normativ Nr. 4, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 87/2012, datë 18.09.2012 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.08.2012 të

Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre"";

- Udhëzimi Nr. 20, datë 25.11.2010 "Për zbatimin e programeve paraprake të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurave të bazuara në analizën e rreziqeve dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) në stabilimente ushqimore";
- Udhëzimi Nr. 21, datë 25.11.2010 "Kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore";
- Udhëzimi Nr. 22, datë 25.11.2010 *"Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor";*
- Urdhri Nr. 235, datë 20.05.2014 "*Për kërkesat e gjurmueshmërisë të produkteve ushqimore me origjinë shtazore".*

IV.2.2. Sektori i Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore

Ky sektor do të auditohet në drejtim të respektimit dhe zbatimit të legjislacionit të sigurisë ushqimore, për detyrat e lëna subjekteve, objekt inspektimi dhe verifikimit të zbatimit të tyre;

Në fushën e mbrojtjes së bimëve:

- Ligji Nr. 105/2016, datë 27.10.2016 "Për Mbrojtjen e Bimëve";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1188, datë 20.8.2008 "Për miratimin e rregullave për importin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve" i ndryshuar.

Në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor:

- Ligji Nr. 10416, datë 07.04.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor".

Në fushën e tregtimit të plehrave për përdorim për bimësinë:

- Ligji Nr. 10390, datë 03.03.2011"Për plehrat e përdorimit për bimësinë";
- Ligji Nr. 64/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 10390, datë 03.03.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë";
- Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së Nr. 4277, datë 01.12.2015 "*Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim*;
- Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së Nr. 4385, datë 09.12.2015 *"Për procedurën e inspektimit dhe formulimin e vendimeve.*

V. AUDITIME FINANCIARE PËR TË GJITHA STRUKTURAT E VARTËSISË SË AKU-së, TË PLANIFIKUARA.

V.1. Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në kryerjen e shpenzimeve dhe të ardhurave

- Mbi ligjshmërinë e arkëtimeve dhe të pagesave të kryera si dhe bashkëlidhjen e dokumentacionit justifikues dhe regjistrimin e veprimeve kontabël në ditarët përkatës;
- Mbi ligjshmërinë dhe rregullaritetin e kryerjes së shpenzimeve për blerje dhe shërbime;
- Mbi zbatimin e standardeve ligjore për kontabilizimin e veprimeve ekonomike;
- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për llogaritjen e pagave të punonjësve sipas klasifikimit, funksionit, vjetërsisë dhe shtesës për pozicion, diploma etj.

- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për ndalesat e kryera për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, raporte mjekësore, si dhe për llogaritjen e tatimit mbi page;
- Mbi zbatimin e organikës dhe strukturës së miratuar, për Drejtorinë e Përgjithshme
- dhe për Drejtoritë Rajonale të AKU-së;
- Mbi kriteret për planifikimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit;
- Debitorët dhe detyrimet e prapambetura.

V.2. Auditim në drejtim të zbatimit të procedurave për prokurimet publike

Verifikimi i të gjitha blerjeve të realizuara gjatë vitit ushtrimor në përputhje me planin e akorduar dhe me regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike;

- Argumentimi dhe llogaritja e fondit limit sipas nevojave konkrete për pune, mallra dhe shërbime;
- Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës;
- Rakordimi i të gjitha blerjeve dhe përputhja në kohë me urdhër prokurimin, afatet e lëvrimit, cilësinë, hyrjen në magazinë, regjistrimin kontabël deri në likuidimet e tyre;
- Zbatimin dhe respektimin e ligjeve dhe udhëzimeve në fushën e Prokurimeve Publike;
- Verifikimi i dosjeve të prokurimit, si dokumentacioni administrativo-ligjor, teknikо-ekonomik, shpallja e fituesit, lidhja e kontratave deri në likuidimin përfundimtar të tyre;
- Kontrolli i lidhjes dhe zbatimit të kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve e ndërtimeve.

V.3. Auditim mbi administrimin e vlerave materiale, inventarëve dhe sistemimin e tyre

- Mbi dokumentimin dhe regjistrimin e veprimeve me magazinën në ditarët përkatës (hyrje - dalje) dhe rakordimi i tyre;
- Auditimi mbi shpenzimet e karburantit dhe zbatimin e normativave të konsumit për secilin mjet;
- Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e inventarëve dhe sistemimi i tyre;
- Mbi administrimin e dokumentacionit, ruajtjen dhe arkivimin e tyre.

V.4. Auditim mbi mbajtjen e kontabilitetit dhe mbylljen e llogarive vjetore

- Mbi mbajtjen e kontabilitetit në përputhje me ligjet, aktet dhe standardet përkatëse, dhe regjistrimin e veprimeve në përputhje me ligjin *"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare";*
- Mbi pasqyrimin e të gjitha ngjarjeve ekonomike e financiare sipas kohës, origjinës kronologjisë si dhe prekja e të gjitha llogarive sipas natyrës, specifikës për shpenzimet, të ardhurat dhe investimet;
- Mbi rakordimin e çeljes së vitit ushtrimor me bilancin e ushtrimit paraardhës;
- Mbi bazueshmërinë ligjore të përllogaritjes së amortizimit për aktivet e institucionit;
- Mbi zbatimin e udhëzimeve dhe akteve të tjera ligjore që lidhen me përgatitjen e pasqyrave financiare.

VI. AUDITIM I ZONAVE DHE SISTEMEVE ME RISK TË LARTË

Siç edhe është theksuar më sipër, qëllimi i krijimit të Institucioni tonë është Siguria Ushqimore, dhe në këtë kontekst në prioritetet e punës së auditimit do të jenë dhe auditimet në këtë drejtim duke mbuluar me auditim ato sisteme apo sektorë të Drejtorive Rajonale që gjatë auditimit të kryer për vitin 2022 janë vlerësuar me risk të lartë.

Detyra kryesore e auditimit është të përcaktojë nevojat e auditimit dhe përparësitë në lidhje me qëllimin e auditimit për të marrë masa parandaluese dhe kontrolli, për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e mundshme. Gjatë hartimit të planit të zhvillimit të auditimit dhe zbatimit të tij, rëndësi do ti jepet vlerësimit të riskut dhe informacioneve të reja për vlerësimin e risqeve në të ardhmen. Zona me risk të lartë janë konsideruar:

- ***Realizimi i Planit të inspektimeve dhe marrjes së mostrave në \|Pik dhe terren.***
- ***Vlerësimi i inspektimeve të terrenit, në lidhje me lënien e detyrave OBU-ve dhe verifikimit të zbatimit të tyre.***
- ***Pikat e Inspektimit Kufitar, për të cilat do të bëhen auditime në drejtim të përputhshmërisë ligjore dhe dokumentacionit autorizues, verifikues dhe shoqërues të praktikave të inspektimit, mbi bazën e të cilave aplikohen edhe tarifat përkatëse, gjatë importit/eksportit/tranzitimit të produkteve objekt inspektimi.***
- ***Vlerësimit të dokumentacionit shoqërues për produktet e importit.(OSH dhe MBIB)***
- ***Vlerësimi i detyrimeve të prapambetura dhe atyre që krijohen rishtazi në Njësitë e Vartësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme.***

VII. PËRMIRËSIMI I KAPACITETEVE ADMINISTRATIVE TË AUDITIMIT

Për realizimin e misionit të auditimit një rol shumë të rëndësishëm luan dhe përmirësimi i kapaciteteve njerëzore të Sektorit të Auditimit. Lidhur me këtë komponent është bërë përpjekje nga ana e punonjësve të auditimit në drejtim të trajnimit dhe kualifikimit për ngritjen e nivelit tekniko-profesional për të punuar konform standardeve dhe praktikave më të mira. Në këtë kontekst është implementuar me sukses gjatë misioneve të auditimit Manuali i Procedurave për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik. Gjithashtu auditi i brendshëm në auditimet në vijim do të implementojë në të gjitha auditimet edhe elementët e auditimeve të performancës në kuptim të vlerësimit të objektivave, programeve dhe shkallës së realizimit të tyre, në lidhje me kursimin, dobinë dhe frytshmërinë, me qëllimin final rritjen e sigurisë ushqimore.

Gjatë punës së tij, punonjësit e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në AKU, një vëmendje të veçantë do ti kushtojnë ruajtjes së paanshmërisë, pavarësisë, integritetit personal, ruajtjes së kofidencialitetit, përmbushjes së objektivave dhe synimeve të vendosura si dhe transparencës në pasqyrimin e të dhënave gjatë auditimeve.

VIII. BILANCI I BURIMEVE DHE NEVOJAVE PËR AUDITIM

Në këtë bilanc i cili është edhe i pasqyruar në tabelën përkatëse (formati nr. 5), janë llogaritur fondi kalendarik i kohës së punës për ditë njerëz të punuar për të nxjerrë koston e auditimit për subjektet e programuara për auditime gjatë vitit 2022.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në AKU ka në përbërje tre punonjës, sipas strukturës së miratuar (një përgjegjës sektori dhe dy specialist: 1+2). Nisur nga detyrimi për auditim të subjekteve të vartësisë sipas kërkesave të MAB, për dhënien e shërbimeve të sigurisë e këshillimit me cilësi, për të vlerësuar efektivitetin e sistemeve të menaxhimit financiar, menaxhimin e riskut, volumi i punës i llogaritur në ditë njerëz, sasia e auditimeve të realizuara gjatë vitit 2022, mendojmë se kapaciteti aktual, administrativ i njësisë së auditimit të brendshëm me tre punonjës është i mjaftueshëm, për të mbuluar drejtoritë rajonale me auditim vjetor si dhe për të përmbushur objektivat e sektorit, sipas planifikimit për vitin 2023. Për vitin 2023, janë parashikuar të kryhen tetë auditime, përfshirë këtu auditime të kombinuara *(financiare dhe të përputhshmërisë),* duke mbuluar me auditim shtatë subjektet të planifikuara sipas sistemeve/fushave dhe sektorëve përkatës të cilët janë vlerësuar sipas riskut, si dhe një auditim që do të kryhet tek të gjithë subjektet e vartësisë për të verifikuar nivelin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në vitet 2021-2022.

Bashkëngjitur janë formatet standard të cilat pasqyrojnë më në detaje aktivitetin e punës që do të realizohet nga Sektori i Auditimit të brendshëm për vitin 2023, si dhe planifikimin strategjik për vitet (1+2) 2023 – 2025.

IX. SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË

NJAB-ve mbështetur në burimet dhe treguesit e performancës, do të sigurojë që audituesit e Brendshëm, zotërojnë aftësitë dhe njohuritë e domosdoshme për të ushtruar detyrat e ngarkuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për këtë NJAB, do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e saj nëpërmjet:

- Vetëvlerësimit, duke plotësuar dosjet e auditimit, me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas hapave të auditimit si dhe vlerësime risku;
- Reagimeve të subjekteve të audituara.

Nga NJAB është përgatitur edhe një program i veçantë për sigurimin e cilësisë, program i cili është miratuar nga Menaxhimi i Lartë me Nr.3208.Prot datë 31.08.2021.Ky program është i përbërë nga 6 anekse të cilat parashikojnë vlerësimin e cilësisë në të gjitha fazat e një misioni auditimi.

Përgjegjës Sektori i Auditimit të Brendshëm

_____

Alfred Çollaku